D.u. Parlamentit
15.01.21

KUVENDI
NR 175 DATE 14.01.21

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 186 Prot. Tiranë, më 14.01 2021

Lënda: Dërgohet dekreti i Presidentit të Republikës.

KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tiranë

Bashkëlidhur, ju dërgojmë Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 11915, datë 14.01.2021 "Për kthimin e ligjit nr. 168/2020 "Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 8.9.2008 'Për miratimin e niveleve të tarifës doganore', të ndryshuar"", së bashku me arsyet e kthimit të ligjit.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Ornela Zonja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SEKRETARI I PËRGJITHSHËM PRESIDENTI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI

D E K R E T

PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 168/2020 "PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9981, DATË 8.9.2008, "PËR MIRATIMIN E NIVELEVE TË TARIFËS DOGANORE", TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 85, pika 1 dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

D e k r e t o j:

Kthimin në Kuvend për rishqyrtim të ligjit nr. 168/2020 "Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 8.9.2008 "Për miratimin e niveleve të tarifës doganore", të ndryshuar", sipas arsyetimit bashkëlidhur këtij dekreti.

Nr. Dekretit 11915
Tiranë, më 14.01.2021

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

ILIR META

ARSYET E KTHIMIT
TË LIGJIT NR. 168/2020 "PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9981, DATË 8.9.2008, "PËR MIRATIMIN E NIVELEVE TË TARIFËS DOGANORE", TË NDRYSHUAR"

Të nderuar deputetë,

Në seancën plenare të datës 23 dhjetor 2020, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 168/2020 "Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 8.9.2008, "Për miratimin e niveleve të tarifës doganore", të ndryshuar". Ky ligj i është përcjellë Presidentit të Republikës për dekretim dhe shpallje me shkresën nr. 3273 prot., datë 30.12.2020 të Kuvendit.

Sipas dokumentacionit parlamentar, rezulton se një ligj me përmbajtje të tillë kaq specifike dhe efekte direkte në buxhetin e shtetit, nuk vjen si propozim i Këshillit të Ministrave, por vjen si propozim i deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, zotit Ilir Beqaj, nismë e cila është depozituar në Kuvend në datën 03.11.2020.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit parlamentar *(relacionit shoqërues të projektligjit dhe Raportit të Komisionit për Ekonominë dhe Financat,)* kjo nismë ligjore ka për qëllim të krijojë një lehtësi fiskale në fushën e turizmit detar, e cila favorizon dhe stimulon shtimin e një kategorie specifike të mjeteve lundruese turistike, <u>të cilat për shkak të natyrës dhe kostos së tyre, janë cilësuar sipas propozimit, si më të pëlqyeshme dhe më të aksesueshme për individët.</u>

Më konkretisht, përmes këtij ligji synohet ulja nga **<u>15% në 2 %</u>** të nivelit të tarifës doganore për "***mjetet e tjera ujore <u>për kënaqësi dhe sporte, të fryra me ajër ose gaz</u>***", ku përfshihen kryesisht varkat e gomës (gomonet), në kodin tarifor të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave (NKM) 8903 10, por nuk përjashtohen as mjetet e luksit, si jahtet, për të cilat tashmë Kuvendi, me ligjin nr. 64/2020, i ka përjashtuar edhe nga tatimi mbi vlerën e shtuar në import.

Gjatë shqyrtimit të praktikës parlamentare, me qëllim evidentimin e argumenteve justifikuese mbi nevojën e këtij ligji, nevojë kjo e evidentuar nga deputeti propozues, dhe jo nga ndonjë institucion apo ministria që mbulon këtë çështje veçanërisht shumë specifike, u vlerësua se ligji nr. 168/2020 "Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 8.9.2008, "Për miratimin e niveleve të tarifës doganore", të ndryshuar", paraqet këto problematika:

- **Zgjeron në mënyrë të paargumentuar qartë dhe jokoherente përjashtimet nga zbatimi i regjimit ligjor fiskal, duke rrezikuar qëndrueshmërinë e vetë ligjit bazë nr. 9981, datë 8.9.2008, "Për miratimin e niveleve të tarifës doganore", i ndryshuar;**
- **Shton precedentët për një efekt të mëtejshëm zinxhir në shtimin e kërkesave të paargumentuara për uljen e nivelit të tarifës doganore, pa një planifikim dhe analizë konkrete financiare;**

- **Zgjerimi i rrethit të përjashtimeve të kësaj natyre ndikon potencialisht në uljen e të ardhurave doganore nga tarifat doganore, në mënyrë të pakontrolluar, pa analizuar pasojat që do të vijonë nga ndryshime të tilla të shpeshta dhe të shkëputura;**
- **Krijon një diferencim të trajtimit të mallrave të tjera, që i nënshtrohen niveleve të tarifës doganore;**
- **Krijon idenë e një favorizimi me natyrë klienteliste dhe preferenciale, sepse favorizon mjetet e tjera ujore për kënaqësi dhe sporte që përdoren për qëllime kënaqësie dhe argëtimi, ndërkohë që ekonomia e vendit po përballet me një situatë shumë të vështirë ekonomike që kërkon një plan tërësor masash, për përballimin e efekteve të shkaktuara nga pandemia e Covid-19;**
- **Nuk është në harmoni me nevojat emergjente të vendit, si dhe me parashikimet e Institucioneve Financiare, të cilat raportojnë për përkeqësimin e situatës ekonomike në vendin tonë.**
- **Referuar kohës së depozitimit të kësaj nisme në datë 3.11.2020 kur Shqipëria ishte në një situatë epidemike të rënduar dhe me numër shumë të lartë të rasteve të përhapjes së infeksionit Covid-19, apo dhe kohës së miratimit të këtij ligji në datë 30.12.2020, tregon qartë se <u>veprimtaria legjislative e Kuvendit të Shqipërisë nuk është e orientuar drejt nevojave bazike të shtresave më në nevojë të shoqërisë</u>, por për plotësimin e kërkesave të shumë pak individëve që të shtojnë në inventarët e tyre individualë apo të biznesit, mjete të lundrimit të luksit për argëtim.**

Ndërmarrja e këtij propozimi dhe miratimi i këtij ligji për lehtësimin e barrës doganore për mjete luksi ujore për kënaqësi e sporte, të fryra me ajër ose gaz (gomone), ndërkohë që vendi ynë dhe qytetarët përballen me një situatë kaq të vështirë ekonomike, për përballimin e së cilës qeveria ka shfaqur hapur pamundësinë buxhetore për të mbuluar çdo kosto të saj, reflekton mungesë vëmendje ndaj nevojave reale të qytetarëve.

Në përfundimet e misionit të FMN-së, që në muajin nëntor të vitit 2019, para se vendi të goditej nga fatkeqësia natyrore e shkaktuar nga tërmeti dhe më pas nga pandemia, tërhiqet vëmendja se: *"Qeveria duhet të përmirësojë sistemin tatimor të fragmentuar, kompleks,* ***me përjashtime dhe me trajtime preferenciale,*** *të mbaje norma tatimore të moderuara, të sigurojë rimbursimin e TVSH-së, të forcojë institucionet fiskale,* ***të përmirësojë performancën e dobët në realizimin e të ardhurave****, si dhe të adresojë ngushtimin e bazës tatimore".*

Trajtimi i mjeteve ujore për kënaqësi dhe sporte, duke i krijuar lehtësi në tarifën doganore (uljen e saj nga 15 % në 2 %), kërkon një analizë objektive që të justifikojë uljen e saj në dy aspekte të rëndësishme:

a) përfitimin social;
b) përfitimin ekonomik.

Në terma të **përfitimit social**, nuk arrihet të evidentohet shtresa sociale që përfiton në rastin e uljes së kostos së mallrave apo shërbimeve të gjeneruara nga ulja e detyrimit për pagimin e niveleve të tarifës doganore, për mallra që në rastin konkret, janë të destinuara për qëllime turistike, kënaqësie apo argëtimi.

Ndryshe nga ç'mund të justifikohej dhe do ishte i mirëpritur një trajtim i tillë, për mallra apo shërbime të një natyre tjetër, siç mund të jenë, për ilustrim, barnat mjekësore apo çdo pajisje tjetër mjekësore që lidhet me përballimin e situatës shëndetësore të epidemisë në vend.

Ndërkohë që, sa i takon **impaktit ekonomik** që mund të sjellë miratimi i këtij ligji, konstatohet se nuk ka një analizë për të evidentuar përfitimin ekonomik nga kjo nismë legjislative.

Sa më sipër, por edhe për shkak të situatës ekonomike, si dhe raportimeve të cilat vijnë nga institucionet më të larta financiare ndërkombëtare, nëse do të duhet të kishte një nismë për lehtësimin e barrës fiskale, siç është ulja nga detyrimi për pagimin e nivelit të tarifës doganore, kjo nismë duhet të paraqitet **në një kohë të përshtatshme**, por dhe të mbështetet **në një analizë të saktë shifrash** dhe **për mallra dhe shërbime jetike.**

Ndërsa vlerësimi i Qeverisë për uljen e detyrimit për pagimin e tarifës doganore e kategorisë së mjeteve që përdoren për **kënaqësi dhe sporte, nuk u përgjigjet nevojave jetike që po kalon vendi, dhe as parashikimeve të Bankës Botërore për periudhën e pas pandemisë së shkaktuar nga Covid-19.**

Kjo nismë, në relacion dhe në Raportin e komisionit përgjegjës argumentohet me faktin se:

> *"[...] referuar elementit "kosto", evidentojmë se kostoja e mjeteve të lundrimit me fryrje (varkat e gomës apo gomonet etj.), është shumë herë me e ulët se ajo e një jahti, çfarë i bën këto mjete ujore më të aksesueshme nga një masë më e gjerë e popullatës dhe për rrjedhojë edhe më të preferuara. Në këto kushte, ulja e tarifës doganore për këto mjete, do të mundësojë shtim të kërkesës për importim të tyre dhe për rrjedhojë shtim të përdorimit të tyre nga qytetarët apo bizneset specifike (p.sh dhënies me qira për turizëm) duke krijuara kësisoj një klimë akoma më të favorshme drejt stimulimit dhe promovimit të turizmit, duke e bërë atë më atraktiv dhe të konkurueshëm në kompleksitetin e tij."*

Ky argument nuk justifikon dot këtë nismë, pasi në realitet krijon terrenin e përshtatshëm që;

- Vetëm një numri shumë të vogël të individëve mund t'u lehtësohet barra fiskale për këto mjete lundrimi, dhe kjo kategori nuk përfshin qytetarët e thjeshtë, dhe as të pamundurit, apo pensionistët, por bizneset specifike që tregtojnë apo i japin me qera këto mjete; dhe

- Nëse qëllimi real do të ishte vërtet stimulimi dhe promovimi i turizmit, përmbushja e këtij qëllimi kërkon **angazhim serioz të institucioneve përgjegjëse për planifikimin e masave dhe aktiviteteve konkrete që çojnë shkallë shkallë drejt këtij zhvillimi**, duke filluar, por pa u kufizuar, nga përmirësimi i infrastrukturës, apo adresimi me zgjidhje përfundimtare i çështjeve të pronësisë në zonat bregdetare.

Këto çështje, nëse do të kenë vëmendjen e merituar, mund të çojnë në stimulimin e vërtetë të sektorit të turizmit, që nuk mund të pritet të ketë përmirësime nga masa të tilla të shkëputura e të paanalizuara, siç propozohet të jetë ky ligj, përmes shtimit të eksporteve të mjeteve ujore, nga ato të luksit, deri tek ato me fryrje me ajër/gaz për kënaqësi e sporte.

Ndaj në kushtet kur kjo nismë legjislative:

- zgjeron në mënyrë të paargumentuar dhe preferenciale rastet e uljes nga detyrimi për pagimin e nivelit të tarifës doganore;
- krijon në mënyrë të paargumentuar një trajtim fiskal të diferencuar në raport me mallrat e tjera, që i nënshtrohen nivelit të tarifës doganore;
- krijon idenë e një favorizimi me natyrë klienteliste dhe preferenciale, ndërkohë që mund të ketë mallra dhe shërbime të tjera që mund të jenë më jetike për individët, apo ekonominë në tërësi dhe që kanë nevojë për mbështetje në formën e uljes së nivelit të tarifës doganore;
- nuk është në harmoni me nevojat emergjente të vendit, si dhe me parashikimet e institucioneve financiare, të cilat raportojnë për përkeqësimin e situatës ekonomike në vendin tonë;

si President i Republikës, kam vendosur kthimin e këtij ligji për rishqyrtim në Kuvendin e Shqipërisë, i cili duhet të vlerësojë me seriozitet nëse është momenti për të ndërmarrë nisma të tilla, për aplikimin e lehtësimeve fiskale të kësaj natyre.

Nëse miratimi i kësaj nisme sipas Kuvendit dhe qeverisë është "i domosdoshëm", ajo mund të ndërmerret në një kohë të përshtatshme dhe pas studimeve dhe analizave të thelluara financiare. Qeveria dhe Kuvendi duhet të rrisin përpjekjet për të përqendruar aplikimin e lehtësimeve në kategoritë e mallrave dhe shërbimeve që kanë më shumë nevojë për politika fiskale mbështetëse.

Vetëm kështu mund të garantohet **mbrojtja më e mirë e interesit publik**, që siç ka theksuar edhe Gjykata Kushtetuese, është i lidhur drejtpërdrejt edhe me mirëfunksionimin e buxhetit të shtetit [...]. Qëndrueshmëria e buxhetit të shtetit është e rëndësishme të garantohet në çdo kohë, por ajo merr një rëndësi të veçantë gjatë periudhave të vështira që diktohen nga kriza ekonomike, prej së cilës nuk mund të përjashtohet sistemi ekonomiko- financiar shqiptar[1].

[1] Vendim nr. 2 datë 18.02.2013, i Gjykatës Kushtetuese.

Qeveria është përgjegjëse për stabilitetin ekonomiko-financiar të vendit dhe për këtë arsye ajo ka detyrimin të ndërhyjë në çdo rast kur një gjë e tillë rrezikon të përkeqësohet. Nisur nga fakti që aktualisht vendi ynë po përballet me pasojat e dy fatkeqësive natyrore të shkaktuara, e para që prej tërmetit të datës 26 nëntor 2019, ndërsa e dyta si pasojë e situatës globale për shkak të pandemisë së shkaktuar nga infeksioni Covid-19, qeveria shqiptare më së pari, ka përgjegjësinë të jetë e kujdesshme si në shpenzime, por edhe në ndërmarrjen apo mbështetjen *a priori* të nismave të tilla ligjvënëse.

Është jo e drejtë dhe aspak e mirëpritur që kjo nismë ligjore miratohet ndërkohë kur shumë familje dhe biznese të prekura nga fakteqësitë natyrore janë ende në pritje që të trajtohen me mbështetje financiare për ndërtimin e banesës së shkatërruar nga tërmeti, apo të ndihmave lehtësuese për shkak të papunësisë nga këto muaj izolimi.

Është për të ardhur keq që vëmendja e Kuvendit dhe Qeverisë në këto kohë të vështira të përqendrohet në uljen e tarifave doganore për mjetet e lundrimit, ndërkohë që kjo vëmendje duhej të fokusohej **për të eksploruar çdo mundësi, për të realizuar atë detyrim që shteti ka përkundrejt qytetarëve të tij, e të përballojë për çdo shtetas barrën[2] e kostos social-ekonomike dhe të shpenzimeve shëndetësore të shkaktuar nga Covid-19.**

Ndërkohë, përkundër kësaj pritshmërie legjitime, qeveria shqiptare reagon në krah komplet të kundërt, duke ndërmarrë nisma ligjore për lehtësimin fiskal të disa subjekteve që do të importojnë mjete lundruese luksi, ose jo për sport dhe argëtim.

Në këtë mënyrë, çdo masë që ka impakt ekonomiko-financiar, qoftë në formën lehtësuese për kategori të caktuara, duhet vlerësuar paraprakisht në raport me gjendjen e diktuar, në interes të të gjithë shtetasve, duke **respektuar raportin e drejtë midis interesit publik dhe garantimit të mirëfunksionimit të buxhetit publik**, si dhe **të përbëjë mekanizëm real të nxitjes së zhvillimit në një sektor apo nënsektor të caktuar**.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Shqipërisë,

Për gjithë sa u parashtrua më sipër, në bindje të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 85 pika 1 të saj, kam vendosur kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 168/2020 *"Për një ndryshim në ligjin nr. 9981,*

---

[2] Neni 4, germa "e)" e ligjit nr. 15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksionevedhe sëmundjeve infektive", sanksionon: *"[...]e) çdo person i sëmurë nga sëmundjet infektive me karakter epidemik ka të drejtën dhe detyrimin* ***të mjekohet falas në çdo institucion shëndetësor publik apo jopublik;[...]"***

datë 8.9.2008, "Për miratimin e niveleve të tarifës doganore", të ndryshuar", **pasi ky ligj nuk i përgjigjet situatës ekonomike të vendit dhe krijon trajtim të diferencuar dhe të padrejtë të shoqërisë në kundërshtim me parimet e mbrojtura nga neni 18, i Kushtetutës dhe nuk është aspak në përmbushje të synimeve për plotësimin e objektivave socialë të parashikuara në nenin 59 të Kushtetutës.**

Sinqerisht,

Ilir Meta